

LIGJ
PËR VENDOSJEN E RRJETIT PËR GRUMBULLIMIN E TË DHËNAVE TË
KONTABILITETIT NGA EKONOMIA BUJQËSORE

Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", Nr. 110/07 prej 14.09.2007

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.
Përmbajtja e Ligjit

Me këtë ligj rregullohet vendosja e rrjetit për grumbullimin e të dhënave të kontabilitetit nga ekonomia bujqësore dhe mënyra e grumbullimit, përpunimit dhe shfrytëzimit të të dhënave të kontabilitetit nga ekonomia bujqësore.

Neni 2.
Kuptimi i nocioneve

Nocionet e përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin si vijon:

1. **Të dhëna të kontabilitetit** janë të dhënat e caktuara teknike, financiare ose ekonomike, të fituara nga evidenca e kontabilitetit të ekonomisë bujqësore, të mbajtur rregullisht dhe sistematikisht gjatë vitit të kontabilitetit.
2. **Ekonomi bujqësore** është tërësia organizative dhe tërësi e rrumbullakuar ekonomike afariste në të cilën kryhet veprimtari bujqësore dhe për të cilën mbahet evidencë në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, ka dhe/ose disponon me pronë bujqësore. Ekonomia bujqësore përfshin një ose më tepër njësi prodhuese. Ekonomi bujqësore mund të jetë personi juridik dhe/ose ekonomia bujqësore familjare;
3. **Bartës i ekonomisë bujqësore** është personi juridik ose fizik i regjistruar në Regjistrin themeltar të ekonomive bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së ujërave;
4. **Vit i kontabilitetit** - do të thotë viti kalendarik ose periudha tjetër kohore prej 12 muajsh të njëpasnjëshëm.

II. VENDOSJA E RRJETIT PËR GRUMBULLIMIN E TË DHËNAVE TË
KONTABILITETIT NGA EKONOMIA BUJQËSORE

Neni 3.
Qëllimet

Rrjeti për grumbullimin e të dhënave të kontabilitetit nga ekonomia bujqësore (në tekstin e mëtejshëm: rrjeti) i dedikohet:

- identifikimit të të ardhurave vjetore të ekonomisë bujqësore dhe
- analizës ekonomike të ekonomive bujqësore dhe vlerësimit të gjendjes së bujqësisë dhe të tregjeve me prodhime bujqësore.

Neni 4. Bartës të rrjetit

Në rrjet janë të përfshira subjektet dhe institucionet në vijim:

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (në tekstin e mëtejshëm: Ministria);
- Komiteti Nacional i rrjetit për të dhënat e kontabilitetit nga ekonomia bujqësore (në tekstin e mëtejshëm: komiteti);
- Seksioni i të dhënave të kontabilitetit nga ekonomia bujqësore në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (në tekstin e mëtejshëm: seksioni), në cilësi të Agjencisë së lidhjeve;
- Enti shtetëror i statistikës (në tekstin e mëtejshëm: enti);
- Agjencia për nxitjen e zhvillimit të bujqësisë, me seli në Manastir (në tekstin e mëtejshëm: agjencia), në cilësi të trupit për grumbullimin e të dhënave të kontabilitetit në nivel të ekonomive bujqësore dhe
- ekonomitë bujqësore.

Neni 5. Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave

- 1) Ministria është organi i vetëm shtetëror i cili ka kompetencë për vendosjen dhe realizimin e rrjetit dhe është shfrytëzues themelor i të dhënave të të njëjtit, në funksion të realizimit të qëllimeve nga neni 3 i këtij ligji.
- 2) Në kuadër të rrjetit, Ministria nga paragrafi 1 i këtij neni:
 - e miraton planin për zgjedhjen e ekonomive bujqësore reprezentative me qëllim të grumbullimit të të dhënave të kontabilitetit, në bazë të mendimit të komitetit nga neni 6, paragrafi 3. alineja 1 e këtij ligji;
 - e miraton listën e ekonomive bujqësore reprezentative në bazë të komitetit nga neni 6. paragrafi 3. alineja 2 e këtij ligji;
 - e miraton marrëveshjen për grumbullimin e të dhënave të ekonomive bujqësore reprezentative, në bazë të mendimit të komitetit nga neni 6. paragrafi 3. alineja 3 e këtij ligji dhe
 - e përvetëson përmbledhjen e të dhënave të përpunuara të kontabilitetit para shpalljes së tyre.

Neni 6. Komiteti Nacional

- 1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (në tekstin e mëtejshëm: ministri), formon Komitetin Nacional të rrjetit për të dhënat e kontabilitetit nga ekonomia bujqësore.
- 2) Komiteti nga paragrafi 1 i këtij neni është trup këshillëdhënës i cili ia jep mendimet ministrit në lidhje me grumbullimin, përpunimin dhe shfrytëzimin e të dhënave të kontabilitetit nga ekonomia bujqësore.
- 3) Komiteti nga paragrafi 1 i këtij neni i kryen detyrat në vijim:
 - jep mendim për planin e zgjedhjes së ekonomive bujqësore reprezentative me qëllim të grumbullimit të të dhënave të kontabilitetit;
 - jep mendim për raportin e zgjedhjes së ekonomive bujqësore reprezentative me qëllim të grumbullimit të të dhënave të kontabilitetit;
 - jep mendim për marrëveshjen e përgatitur nga seksioni në pajtim me nenin 12. paragrafin 2 të këtij ligji dhe të dorëzuar komitetit në pajtim me nenin 7. paragrafin 2. alinenë 7 të këtij ligji.

- 4) Komiteti nga paragrafi 1 i këtij neni përbëhet prej 10 anëtarëve dhe atë:
 - dy anëtarë të emëruar nga ministri;
 - dy anëtarë të emëruar nga ministri i Financave;
 - një anëtar nga Fakulteti i shkencave bujqësore dhe i ushqimit - Katedra e ekonomisë dhe organizimit të bujqësisë;
 - një anëtar nga seksioni nga neni 7 i këtij ligji;
 - një anëtar nga enti nga neni 8 i këtij ligji;
 - një anëtar nga agjencia nga neni 9 i këtij ligji;
 - një anëtar përfaqësues i shoqatave nga sfera e bujqësisë, dhe
 - një anëtar përfaqësues i odave ekonomike.
- 5) Në mbledhjen konstituive komiteti nga paragrafi 1 i këtij neni miraton rregulloren e punës me të cilën rregullohet mënyra e punës së komitetit dhe zgjedh kryetarin e komitetit dhe zëvendësin e tij nga radhët e anëtarëve nga paragrafi 4 i këtij neni.
- 6) Mendimet nga paragrafi 3 i këtij neni miratohen me anë të marrjes së vendimit të njëzëshëm.
- 7) Nëse komiteti nuk anin të miratojë mendimin në pajtim me paragrafin 6 të këtij neni në afat prej një muaji nga dita e pranimit të nevojës për konsultime lidhur me detyrat nga paragrafi 3 i këtij neni, do të vendosë ministri.
- 8) Shërbimet e përgjithshme dhe administrative lidhur me punën e komitetit do të sigurohen nga Ministria.

Neni 7. Agjencia e lidhjeve

- 1) Për nevojat e këtij ligji, Seksioni i të dhënave të kontabilitetit nga ekonomitë bujqësore në kuadër të Ministrisë do të ketë rolin e Agjencisë për lidhje.
- 2) Seksioni nga paragrafi 1 i këtij neni i kryen detyrat në vijim:
 - përgatit dhe i dorëzon Ministrisë dhe komitetit nga neni 6 i këtij ligji planin për zgjedhjen e ekonomive bujqësore reprezentative me qëllim të grumbullimit të të dhënave të kontabilitetit, më së voni tre muaj para fillimit të vitit të ardhshëm të kontabilitetit;
 - entit nga neni 8 i këtij ligji i paraqet planin për zgjedhjen e ekonomive bujqësore reprezentative për mbledhjen e të dhënave të kontabilitetit, me qëllim të përgatitjes së listës të ekonomive bujqësore të përmendura;
 - përgatit dhe i dorëzon Ministrisë dhe komitetit nga neni 6 i këtij ligji raport për zgjedhjen e ekonomive bujqësore reprezentative me qëllim të grumbullimit të të dhënave të kontabilitetit më së voni një muaj para fillimit të vitit të ardhshëm të kontabilitetit;
 - komitetit nga neni 6 i këtij ligji, i paraqet mendimin për përparimin e punës lidhur me grumbullimin dhe shfrytëzimin e të dhënave të kontabilitetit;
 - çdo vit të mendimit komitetit i dorëzon marrëveshjen e lidhur me agjencinë, në pajtim me nenin 12. paragrafi 2 i këtij ligji;
 - i verifikon të dhënat e mbledhura dhe të dorëzuara nga agjencia nga neni 9 i këtij ligji dhe të njëjtat ia dorëzon Ministrisë dhe
 - e përgatit dhe shpall përmbledhjen e të dhënave të kontabilitetit, në publikimet e veta.

Neni 8.
Enti shtetëror i statistikës

- 1) Për nevojat e këtij ligji, enti do të luajë rol në zgjedhjen e ekonomive bujqësore reprezentative në bazë të të dhënave nga regjistrimi i bujqësisë.
- 2) Enti nga paragrafi 1 i këtij neni, në bazë të planit për zgjedhje të ekonomive bujqësore reprezentative nga neni 7, paragrafi 2. alineja 1 e këtij ligji, përgatit listën e ekonomive bujqësore reprezentative në bazë të procedurës nga neni 15 i këtij ligji.
- 3) Enti nga paragrafi 1 i këtij neni do ta përgatisë dhe do t'ia dorëzojë seksionit listën nga paragrafi 2 i këtij neni më së voni dy muaj para fillimit të vitit të ardhshëm të kontabilitetit.

Neni 9.
Trupi për grumbullimin e të dhënave të kontabilitetit

- 1) Për nevojat e këtij ligji, Agjencia për nxitjen e zhvillimit të bujqësisë do të ketë rolin e trupit për grumbullimin e të dhënave të kontabilitetit në nivel të ekonomive bujqësore.
- 2) Agjencia nga paragrafi 1 i këtij neni i kryen detyrat në vijim:
 - lidh marrëveshje me bartësit e ekonomive bujqësore nga të cilët do të grumbullohen të dhënat e kontabilitetit;
 - u ndihmon bartësve të ekonomive bujqësore në përgatitjen e të dhënave të kontabilitetit;
 - i mbledh dhe i paraqet në formë elektronike të dhënat e kontabilitetit nga ekonomitë bujqësore dhe
 - ia dorëzon seksionit nga neni 7 i këtij ligji të dhënat e kontabilitetit në vëllim dhe formë në pajtim me nenin 11 të këtij ligji.

Neni 10.
Ekonomi bujqësore

- 1) Ekonomia bujqësore mund të jetë pjesë e rrjetit nëse i plotëson kushtet në vijim:
 - të ketë orientim tregtar dhe të ketë madhësi ekonomike minimale të konfirmuar nga ana e Ministrisë;
 - të paraqesë ekzemplar reprezentativ në nivel të rajonit dhe të shtetit, dhe
 - bartësi i ekonomisë bujqësore të mbajë evidencën e kontabilitetit ose të jetë i përgatitur të fillojë të mbajë evidencën e kontabilitetit dhe të jetë në pajtim me të dhënat e kontabilitetit nga ekonomia bujqësore, t'i bëjë të kapshme për nevojat e rrjetit.

III. GRUMBULLIM, PËRPUNIM DHE SHFRYTËZIM I TË DHËNAVE TË KONTABILITETIT NGA EKONIMITË BUJQËSORE

Neni 11.
Të dhënat e kontabilitetit

- 1) Të dhënat e kontabilitetit të cilat janë objekt i grumbullimit nëpërmjet rrjetit përfshijnë:
 - informata të përgjithshme për ekonominë bujqësore dhe veçanërisht numrin e identifikimit të ndarë për qëllimin e grumbullimit të të dhënave

- të kontabilitetit, përshkrimin e lokalitetit të ekonomisë bujqësore dhe tipin e prodhimit bujqësor;
- sipërfaqen e tokës së ekonomisë bujqësore në pajtim me strukturën e pronës;
 - resurset njerëzore në disponimin (fuqia punëtore personale dhe e angazhuar);
 - numrin dhe vlerën e kafshëve shtëpiake në fillim dhe në fund të vitit të kontabilitetit dhe gjendjen gjysmëvjetore, sipas llojeve dhe grupeve;
 - furnizimin dhe shitjen e kafshëve shtëpiake në vitin e kontabilitetit, sipas llojit;
 - harxhimet në lidhje me prodhimin bujqësor;
 - mjetet e ekonomisë bujqësore dhe disponimin me to gjatë vitit të kontabilitetit;
 - borxhet dhe kërkesat;
 - tatimin e mallrave dhe të shërbimeve (TVSH);
 - grantet, subvencionet dhe pagesat direkte;
 - shitjen e prodhimeve me origjinë bimore dhe shtazore në vitin e kontabilitetit;
 - kufizimet e ndara të prodhimtarisë bujqësore dhe
 - të dhënat plotësuese të kontabilitetit, të nevojshme për mënjanimin e qëllimeve nga neni 3 i këtij ligji.
- 2) Të dhënat e kontabilitetit nga paragrafi 1 i këtij neni grumbullohen nga ekonomia bujqësore në formën e cila mundëson:
- tipizimin e ekonomisë bujqësore në lidhje me elementet themelore të faktorëve prodhues të tij;
 - vlerësimin e të ardhurave të ekonomisë bujqësore në të gjitha format dhe
 - kontrollin e besueshmërisë së të dhënave të dhëna nëpërmjet kontrollit të vendit të prodhimit.
- 3) Të dhënat e kontabilitetit mbledhen me anë të formularit unik.
- 4) Ministri e përcakton vëllimin dhe mënyrën e grumbullimit të të dhënave të kontabilitetit nga paragrafi 1 i këtij neni, si dhe përmbajtjen e formularit të vetëm nga paragrafi 3 i këtij neni, në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 12. Grumbullimi i të dhënave

- 1) Të dhënat e kontabilitetit nga neni 11 i këtij ligji i grumbullon seksioni me ndërmjetësimin e agjencisë.
- 2) Seksioni lidh marrëveshje vjetore me agjencinë për grumbullimin e të dhënave të kontabilitetit nga ekonomitë bujqësore reprezentative të përcaktuara në listën e ekonomive bujqësore reprezentative nga neni 15. paragrafi 1 i këtij ligji.
- 3) Marrëveshja nga paragrafi 2 i këtij neni përmban së paku:
- vëllimin e të dhënave të kontabilitetit nga neni 11 i këtij ligji, të cilat duhet të mbledhen;
 - numrin e ekonomive bujqësore të cilat do të sigurojnë qasjen e të dhënave të kontabilitetit të tyre;
 - afatet përfundimtare dhe mënyrën e dorëzimit të të dhënave të mbledhura të kontabilitetit nga viti i kontabilitetit;
 - kushtet e pagesës së agjencisë;
 - formën e mbrojtjes së të dhënave të kontabilitetit;

- formën e mbrojtjes së të dhënave personale të bartësve të ekonomive bujqësore në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe
- dispozitat ndëshkimore për mosplotësimin e marrëveshjes.

Neni 13.

Pëlqimi për grumbullimin e të dhënave

- 1) Të dhënat e kontabilitetit mblidhen nga ekonomitë bujqësore, bartësit e të cilave janë pajtuar me grumbullimin e të dhënave të kontabilitetit në vitin e caktuar të kontabilitetit dhe për këtë kanë nënshkruar marrëveshje me agjencinë.
- 2) Marrëveshja nga paragrafi 1 i këtij neni përmban së paku:
 - të dhënat e kontabilitetit të cilat janë objekt i grumbullimit në pajtim me vëllimin nga neni 11. paragrafi 4 i këtij ligji dhe afatet përfundimtare të dorëzimit të të dhënave;
 - formën e mbrojtjes së të dhënave të kontabilitetit dhe
 - formën e mbrojtjes së të dhënave personale të bartësve të ekonomive bujqësore në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 14.

Shfrytëzimi i të dhënave

- 1) Të dhënat e kontabilitetit të mbledhura nga ekonomitë bujqësore mund të shfrytëzohen vetëm për qëllimet nga neni 3 i këtij ligji. Të dhënat e kontabilitetit nuk mund të shfrytëzohen për tatim.
- 2) Të dhënat personale të bartësve të ekonomive bujqësore mbrohen në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 15.

Zgjedhja e ekonomive bujqësore

- 1) Enti, në bazë të planit të përpunuar nga neni 7. paragrafi 2. alineja 1 do të përpunojë, nëpërmjet të zgjedhjes së rastësishme, listën e ekonomive bujqësore reprezentative, me qëllim të grumbullimit të të dhënave të kontabilitetit dhe listën e përmendur do t'ia dorëzojë seksionit.
- 2) Lista do të përmbajë:
 - RAJONIN (numrin statistikor të identifikimit) dhe
 - Emrin, mbiemrin, NUAQ dhe adresën e bartësit të ekonomisë bujqësore.

Neni 16.

Financimi i rrjetit

- 1) Mjetet për financimi e rrjetit sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë nëpërmjet programit të veçantë buxhetor në buxhetin e Ministrisë.
- 2) Harxhimet në vijim janë të kapshme për financim nga mjetet e theksuara në paragrafin 1 të këtij neni:
 - harxhimet materiale për punën e komitetit nga neni 6 i këtij ligji;
 - harxhimet e rrjetit që kanë të bëjnë me seksionin, për realizimin e detyrave nga neni 7. paragrafi 2 i këtij ligji;
 - harxhimet e rrjetit që kanë të bëjnë me agjencinë, për realizimin e detyrave nga neni 8. paragrafi 2 i këtij ligji dhe

- harxhimet për kompensim të ekonomive bujqësore që participojnë në rrjet.

IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 17.

Miratimi i akteve nënligjore

Ministri do t'i miratojë dispozitat nënligjore për zbatimin e këtij ligji në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 18.

Themelimi i Komitetit Nacional

Komiteti nga neni 6 i këtij ligji formohet më së voni në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 19.

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 janari i vitit 2008.